



Mehmet Bislimi - BURRËRI E LAGUR

Mehmet Bislimi

BURRËRI E LAGUR

... nën petkun e paraqitjes së radhës, dalë e ngadalë po mundohem t'i unifikoi gjallimet e mia nëpër vite përpjekjesh, dhimbjesh, vuajtjesh e përkushtimesh të cilat veç se thyejnë njëtrajtshmërinë e jetës së përditshme, njëkohësisht shënojnë edhe atë hapin pasues, ku krejt natyrshëm duhet të puqet njeriu me njeriun!

Kjo puqje, në ritualizmin e konotacionit kohë, bëhet aq e domosdoshme sa zbret deri në rrafshin e parimeve më elementare të asaj që i thonë etikë!, si e tillë merr mbi supe obligimin e skajshëm, që nënvetëdijen e vet thërret: o njerëz, ejani e shëroni plagët e shpirtit!

- Autori



(Poezi satirike)

Mehmet Bislimi
BURRËRI E LAGUR

Mehmet Bislimi
BURRËRI E LAGUR
(poezi satirike)

Redaktor:
Kadri Rexha

Lektor:
Emin Halimi

Recensent:
Adnan Asllani

Ballina dhe faqosja
Sabir Krasniqi

Botues:
PPG “Shkrola”
Prishtinë

Copyright & 2012
Autori

Mehmet Bislimi

BURRËRI E LAGUR

(poezi satirike)

Hyrje

E ndjej obligim moral që të shpjegoj lexuesin e nderuar se kjo përmbledhje me poezi satirike me titull: “ Burrëri e lagur”, Prishtinë 2013 del si ndjenjë imja, si shqetësim imi, si revoltë imja e grumbulluar prej kohësh nga paudhësitë e shumta që edhe sot janë të pranishme në shoqërinë dhe jetën tonë të përditshme. Sigurisht jo në përmasat e një zhgënjimi, sepse do të ishte fatale për një shoqëri që pretendon një prosperitet dhe zhvillim ekonomik, politik, kulturor e demokratik. Megjithatë, pa dyshim se ne duhet t’i luftojmë dukuritë negative kudo që shfaqen ato, madje duke i vënë në thumb të kritikës përditë, ngado dhe kudo.

Poezitë satirike që po i ofroj lexuesit (një pjesë e madhe e tyre), kanë qenë të botuara në përmbledhjet e mia të mëparshme me poezi, por edhe në shtypin e kohës pjesërisht gjatë viteve 1995-2012, tani të përmbledhura në këtë botim të veçantë me ndryshime modeste, si : “ Trëndafila maji”, Prishtinë 2002, “Fjalë dhe gurë”, Prishtinë 2003, “Ironi e verdhë”, Prishtinë 2005, “ Stinë e vonuar”, Prishtinë 2008, “Shpirtndrituri”, Prishtinë 2012 etj.

Qëllimi i vetëm dhe i fundit i mesazhit tim për mes këtyre poezive satirike është: goditja e dukurive negative në shoqërinë tonë demokratike e pluraliste, në hapat e zhvillimit të saj të brishtë, e cila ende nuk po mund të mëkëmbet, pa dyshim nga se brendapërbrenda saj, brejtësit e shumtë po e brejnë atë si miu, prandaj, përderisa ka brejtës të tillë, ne duhet t'i godasim ata pa hezitim.

Nisur nga ky këndvështrim, jam munduar (ketë do ta vlerësojnë më mirë kritika e mirëfilltë dhe lexuesi), që përmes vargut satirik të godas dhe të mos i kursej brejtësit e të gjitha kohërave, pa dallim ngjyrash partiake, krahinore, fetare racore etj. Me një fjalë, jam përpjekur që të godas të gjitha dukuritë negative që po vrasin shoqërinë tonë.

- autori

FJALA E REDAKTORIT

Librin me poezi ironike me titull: "Burrëri e lagur" të poetit Mehmet Bislimi, e lexova me një kënaqësi të veçantë, dhe si i thonë fjalës me një frymë! Gjykoj se libri ka dalë mjaftë i mirë. Si titulli ashtu edhe brendia e librit të cilat përfaqësojnë besnikërisht përmbajtjen dhe mesazhin e poezive. Nivel të lakmueshëm shprehës autori ka arritur sidomos me poezitë ironike, të cilat në shumë raste arrijnë deri te sarkazma. Ky lloj i poezisë tek ne është deficitar sepse poetët tonë më shumë imagjinojnë se sa që merren me realitetin shoqëror, me jetën konkrete dhe me problemet e saj. Në fund të fundit shtrohet edhe një pyetje: sa e njohin shkrimtarët tanë realitetin dhe shpirtin e shumëvujtur të shqiptarit, dëshirat, kërkesat, veset, ambiciet, pasionet...? Përvoja jetësore e autorit, intuita e trashëguar e mjedisit ku ai jetoj dhe u rritë, preokupimi i tij shumëvjeçar për çështjen kombëtare, mospajtimi konkret me robërinë individuale dhe kolektive, pjesëmarrja e tij në rezistencën shqiptare kundër okupatorit dhe kolonializmit serb, përjetimet e tij dhe të shokëve të tij burgjeve të okupatorit serb, anëtarësimi dhe roli udhëheqës i tij në frontin e luftës, të gjitha këto janë një bagazh i pasur, sa i hidhur po aq edhe i ëmbël, që autorin e kanë

Mehmet Bislimi

ndihmuar t'i kapë fenomenet në esencë, në rrënjë, duke vërejtur dhe goditur tani shumë devijime që po ndodhin, fatkeqësisht edhe tek shoqëria shqiptare...

Një krah të fortë ndihme në vokacionin e tij poetik e ka edhe nga krijimtaria gojore e popullit tonë e në mënyrë të veçantë nga anekdota aq shumë e kultivuar sidomos në trevën e Drenicës dhe të Dukagjinit. Libri poetik “Burrëri e lagur”, është voluminoz dhe shquhet me një larmi temash ekzistenciale të kombit tonë në një kohë epike, me të gjithë heroizmat dhe ligësitë e saj, që padyshim kanë edhe ironinë brenda si mjet i fortë goditje të të gjitha shëmtive shoqërore të çfarëdo ngjyre qofshin ato.

Poetit dhe publicistit, Mehmet Bislimit i uroi punë të më tejme në lëmin e krijimtarisë poetike dhe publicistike, suksese të reja në të ardhmen!

Mr. Kadri REXHA

LISI I MPLAKUR

Dikur

rojat viheshin tek kullat
nga mali
kur zbrisnin burrat

vdisnin për atdhe
burrat
dikur

vdesin atdheun
burrat
sot

mashkull e burrë
nuk qenka njëjtë
as atëherë
as sot
as kurrë

Dëshmitarë

(*Na ishte njëherë*)

dëshmitarë të kohës ishim
kur zagarë në pikë të ditës
mu në jakën e xhaketës
mbanin firmën e Titos...

atëbotë kolera kishte rënë në Kosovë
ndërgjegje në peshojë
para atdheut
më thuaj
sa t'hoqi kandari he burrë
a vdiq kush nga turpi
më thuaj
shpenzimet e varrimit
t'ia heq unë
unë
dëshmitari

Dy të marrë

u takuan dy të marrë
si të marrë që ishin
bënë shamatë në pazar
në pazarin e Prishtinës

lajmin shënuan gazetat
e bëjnë gjellë e sallatë
sonte kryeqytetasit
nuk do hanë darkën thatë

dy të marrë bëjnë shamatë
gurin në pus e kishin hedhë
do të duhet kohë e gjatë
gurin e të marrëve për ta nxjerrë

Bythë e kuisë
(*Veton Surroit*)

nuk ndenjen duarkryq intelektualët
sfidë serioze i bënë Serbisë
me vizionin filozofik të avancuar
rrahën me shkop bythën e kuisë

bythë e kuisë rënë nga ndryshku
lënë në mezhde me një anë
Vetoni shpiku strategji të re
të artit luftarak në Ballkan

rrethi i kuisë po krekoset
me bythën që boja po i del
eh sikur të realizohej kjo filozofi
do konkurronte çmimin Nobel

Telefoni

lajmi se
tiranin e vranë
më erdhi nga zëri andej telefoni
u gëzova më kot
gëzimi mu fik në çast
po tiraninë që mbolli ai
kush do ta vrasë
për sihariqin
kush do të më thërrasë

Lajm i vonuar

do shtypur të urryerit si kokrrën e grurit
më gurë të rëndë mulliri
që ta shpëtojmë dashurinë
të mblidhet Parlamenti pastaj
për të parë
kush mbolli urrejtje

Rënie

me duar të përgjakura
ju ngritën
në majat më të larta
kujdes nga rënia
më lart nuk ka

panë tmerrin ata
nga mundimi i ngritjes
me duar të këputura në bërryl
kujdes
bërrylin atyre mos ua tregoni
kujdes

Të gjithë

pranë oxhakut
hanim patate të ziera
me kripë
që moti

rreth oxhakut
ngroheshim të gjithë nga pak
nga gjyshi dëgjonim historira
dhe
shprushnim me mashë zjarrin në oxhak

pranë oxhakut tani
hanë gënjeshtër njerëzia
pa kripë
të paziera
nëpër këmbë me zorrë
dialogun vazhdojmë
s'para se u bëmë horë
në krahët e kotësisë dremitur
me shpresa të thyera drobitur

disa ende dëgjojnë përralla
disa marrëzira
disa shprushin me mashë zjarrin
disa shprushin ndyrësira
disa e bëjnë historinë

Mehmet Bislimi

disa nuk marrin erë nga historia
disa i përjetëson
disa i mallkon përjetësisht
historia

Bojën kursejmë

kur isha i ri më kujtohet
delet i bënim me bojë
që të dallohej e jona

tani nuk i bëjmë me bojë
nga zëri i njohim
bojën kursejmë
se boja iu doli
një jetë të tërë vetëm pallën
një fjalë me peshë
nuk e folën
atje ku kishin aderuar
kot hynë
dhe dolën prej loje
dolën boje

Klasë e dështuar

mirë
ta zëmë se ata do të përmirësohen
dhe
injanca do të zhduket ngadalë
po bota
me se do merret më pastaj
politika ditore si do t'ia dalë

Shprehi

me një vendim të pashkruar
i vranë ata
të zot e votës së lirë

tallja me votën e lirë
kaloi në shprehi
deri në përçudnim
secili- secilit gishtin ia drejton
ti je hajni
e hajnin dot s'e zënë

sot
kur ligjin kanë tredhur
barrës kush s'mbeti
votë e vranë e popullit
apo
populli i votës së vranë
hedhur në kuti
rutinë e kotë
paturpësisht
kaloi në shprehi

Djallëzi e mbarë

mbaja kokën fort
ka zjarrmi dhe vrer
të përziëra në stomak
mbase ka ardhur koha
t'i nxjerrë
t'i nxjerrë të palarat
nga para e nga pas
mbaje fort

Dramë

po ndodhin drama
që as në ëndërr s'i kemi parë
ka humbur arsyeja
me dramat rrethuar
aktorët cilët janë

servilë të tërë po lozin sot
nën hundën tonë
dramën e akullt
dramë e kotë
faturën e së cilës
do ta paguajmë më vonë
në rolet e dyfishta
si aktorë
si spektatorë
spektatorë kot
pa as gjë në dorë

Dehje

në rrugën e përbaltur zhgërryer
nga lojë e stërgjyshit të parë
që lëngun e hidhur të limonit
e paska pirë moti dikur
prapa krahëve të vatanit
lëngun e zi ogur
me Sejmenët e Sulltanit

e rëndë
breza të tërë zhgërryer
breza të tërë me shpirt të vrarë
nga të palarat
e stërgjyshit të parë

LUMI QË S'NA LANË

Robërit

kanë përvetësuar rolin
e të qenit rob
kanë bërë përvojë
ata
nuk janë më amatorë

Sintezë fatale

rrugë mora
për ta takuar njeriun
panjerëzinë dhe qenërinë
takova
shkrirë në bashkëdyzim
në analizë nuk u futa dot
të panjerëzishmit
sinteza keq i kishte ngërthyer
ishin bërë t'i qashë me lot

Gomari

të gjithë e duan “gomarin”
qëllimi
barrët t’ia ngarkojnë mbi kurriz
kjo qenka dashuria

ti do thuash
ai është kafshë
mirë pra
po njeriut që s’është i tillë
pse kaq shumë po i hipin në qafë

Horoskopi

ti sot
ai nesër
pastaj tjetri
i pari dhe i fundit
unë
kjo është matematika
të gjithë duan të jenë
të parë dhe të fundit
në hisen e përjetësisë

më thuaj uratë
sipas motit
më parë do të na qajnë
apo shajnë
bijtë e robit
pasuesit e kotit

Mitrovicë

mat e ç'mat
ndaj e bashko
ajo aty mbeti
mbi Ibrin e lashtë
as e ndanë
as e bashkuan
mbase dikujt po ia shalojmë
pse nuk mbytemi të gjithë në lumë
përderisa Ibrin dot se kalojmë

Edipi

sytë i verboi Edipi
në shenjë pendimi e trishtimi

sot pretenduesit e fronit
as pendohen
as trishtohen
as sytë verbojnë
vazhdojnë
lodrojnë
poshtë e lartë
mëmë-dheun

Përrallë

na ishte një kohë njëherë
kur zagarë të tërë
puthadorë të pushtuesit
mohonin atdheun

populli im sa i pa fat
të ligjtë jetuan kaq gjatë
e si mbyti kjo përrallë e thatë
nuk i mbyti
as sot

Dordoleci

në kopshtin e zarzavateve e vunë
një dordolec autokton
ca antike
pak komike
kohë e dordolecëve
në ikje

tani nuk po hanë më fruta
ata
po hanë njëri- tjetrin
simbolikisht
e pas shpinë
ngrëniet nuk pushuan

Padrejtësisht

pse jeton kukudhi
a blihet vdekja me para
mbase asambleja komunale
do të shpallë tenderin
mbi vdekjen

të korruptuarit
në rreth
ndjekjeje me njëri-tjetrin
nga ky rreth vicioz
kush doli i pastër
që ta adhurojmë me krenari

padrejtësisht
krenarinë na e vranë
i vraftë buka e motit
borxh nuk ua patëm
as para robit
as para zotit

Kushtrimi

biri i madh i Adamit
shpall vendime historike
të xhumave
ditë e lutjeve simbolike

sinonim i shterpëzimit
në Prishtinë në derë t'hamamit
shkruar thirrja e kushtrimit
krejt formale
nga pasuesit e Nastradinit
që bënë shtetin e tërfilit

Kosovë
ke vuajtur kaq gjatë
ke vuajtur kaq shumë
me shumë plagë në shtat
Kosovë të kanë hipur
diletantët në qafë

Statujë

mbi gurë gdhenda ngadalë
mundimshëm nxora portretin tënd
dritë e diell pastë
bëma të kohës së lashtë

një statujë të shëmtuar
edhe atyre
që një jetë të tërë
gjuajtën diellin me gurë
atyre një statujë
në mesin e qytetit
të ndihen të braktisur
të ndihen
të huaj

Ka burra

ka burra
që as para plumbit
nuk e hanë fjalën e dhënë

ka burra
që lumi nuk i lanë
si qentë fjalën hanë

ka burra
që gënjejnë shoqi- shojnë
për dallim nga qentë
ata nuk lehin
edhe kur të tjerët i shkelmojnë
ka burra
e burra

Vret fjala

është e ëmbël
kush është zot i saj
me fjalë
zihen armiqtë
fjalën trimat mbajnë

me fjalë lidhen burrat
në flamur t'Skënderbeut
dhe
luhet me fjalë fshehur
n'kurriz të atdheut

Punëtori

kishte harruar
se duhet ndërtuar
diçka edhe për vete

ai harroi për vete
dhe të tjerët për të harruan
në fakt
nga djersë e tij hanë
dhe
djersën e tij vranë
lumi që s'na lanë

BURRËRI E LAGUR

Dallimi

vdekjen kërkujnë
e s'ka kush ua jep
Xhebrailin e kanë korrptuar

vdesin e s'e kuptojnë
vdekje që turpërojnë
vdekje që përjetësojnë
luhatje
para vdekjes dhe jetës
dallimi hendek
për t'i qarë me lot
kush shkoi e kush mbet
i pa tundur
nga uni i vet

Ishull

rrethuar me ujëra të turbullta
burrëri e lagur
ndër vite
Kosovë
përgjakur

ishull i robërisë
lagështi që s'të kalbi
s'të ndryshku

lumenj gjaku Kosova ka
ujë
s'ka

Dilemë

me përkushtim punoi për të tjerët
veten shau
punoi për vete më pastaj
të tjerët e shanë
një jetë të tërë
sharjet s'u ndanë

kur vdiq
e shanë dhe e qanë
sharje dhe qarje aksidentale
si nuk u ringjall Isai - Jezu
shfryrjet e pelegrinëve
mbi pavdekësinë
t'i ndiejë
shpirtit të padjallëzuar
dheu i qoftë i lehtë
amen

Pikëpyetje

ata ia bënë atdheut atë punë
nga gjithë ai nam i zi
vetëm një pikëpyetje mbeti
diku
me ligjin masturbuan

kundër atyre
as sot
qoftë edhe një pikëpyetje
a pikëçuditje
diku
nuk e vunë
prapë
më ligjin masturbuan

Shkëlqimi që vret

të vetmin që do ta vriste shkëlqimi
i hënës gënjeshtare
ishte ai

e kisha vënë re
që moti
yshtur pas hënës së kuqe
që iku në të parin agim
shpresoj mos të të vras
ndjenja e trishtimit
në kuqësinë tënde
miku im

Muralet

i hoqën më parë
se ç' i vunë
muralet në Parlamentin e Kosovës i mbuluan
përfaqësuesit fatalë të popullit
fatur aksidentalisht në lojën e madhe
të kombit
me halle

muralet sot
mbuluar me ferexhe
lojë me historinë
deri në trishtim
përfaqësuesit e platformës neveritëse
netëftohave të dimrit
në peshim
nën peshën e ndjenjës së keqe
muralet në Kuvendin e “burrave” të Kosovës
edhe sot
mbuluar me ferexhe

A do karrocë zotëri

ndjesi trishtimi
shtrirë në shekuj
bijtë e shekullit të ri
në tregun e blertë të Prishtinës
strukur nën lotin e shiut

shpresa të mekura në zërin e një fëmije
që thërret në refren
i ndjenë

A do karrocë zotëri ...

te tregu i blertë i Prishtinës
jo larg spitalit të veremit
u dogj në mjerim poema
dhe mushkëri e Migjenit

A do karrocë zotëri ...

Katarsis

e pabesueshme
kaq shumë pastrim u dashka
në këtë krizë
me reduktime uji e rryme
vështirë se
pastrohet ndërgjegjja

a ka lumë që na lanë

dy sharje ka
e zeza ju shpëlaftë
lumi mos ju laftë

Divorcimi

dy gjenerata
përjetësisht të divorcuara
për hir
të besnikërisë
dhe
tradhtisë
ndaj atdheut

Burrëri

burra

ka

ka pasur

do të ketë

kryefjala dhe kallëzuesi

burri

nuk liget dhe

në pusi të ligësive

nuk bie

kaq e thjeshtë

Anonim

vërtitje kuajsh pa zot
ujq e çakej ndër male
ulërijnë për ty
anonim
enigmë e sprovës së kotësisë

kush të adhurate si hyjni
na thuaj
rrufë e mbaruar
fanatik i mendjelehtësisë
analogji jo bindëse
zgërdhima mes zemërimit
që plagën e mbyllur rihapin
ti fshehur prapa hijes
anonim

Barrëse

fjala mori dheun
Qeveria qenka me barrë

në kuvend
në rend të ditës
kërkesë e opozitës
për kohëzgjatjen e shtatzënisë
dhe atësinë e fëmijës

duam sqarim
menjëherë
ndryshe Kosovës do t'i mbesë
“me ligj”
kopili në derë

Servilizëm

e duartrokitën gjatë
në mënyrë frenetike
me dashje servilizmin mbysnin
e mbysnin me duartrokitje

shuplakë e dorës u dogj
nga skuqjet e duartrokitjeve
servilizmi u poq
se bashku me vesin e lig
as sot
nuk u hoq
në pritje të të marrëve
por edhe në ikje
servilizëm i mbytur
me duartrokitje

Të marrët

për të vetmin gabim
e “dekoruan” me titullin
I marrë

për gabime të shumta më pastaj
është djallëzor thanë

sa më i marrë e më horr
aq më strateg e më djallëzor
teori e filozofisë fataliste në Kosovë
djallëzorët pa brenga
qeverisin e rrojnë

SHPËTIM NGA MALLKIMI

Partitë

e djathtë

e majtë

e qendrës

...

u përligj kjo lojë

përmes përkatësisë partiake

identifikohemi

në fytyrë e serrat

me shterpësinë e gjatë

kancerin morën kryeparët

kancerin në stomak

Standardet

për vjetërsi
vezën dhe pulën
në garë i vunë
në lavatriqe futen llumin
e sistemit të kaluar
na doli më pas i „larë“
hibridi i sprovës së parë

patriotë të shpëlarë
kategori e ripërpunuar
plotësojnë standardin e parë
atdheut për t'ia nxirë
faqen e bardhë

Ligji

ligjin e bënë ata
kundër të tjerëve

iku arsyeja
kush pjerdh për drejtësi
para ligjit e njeriut
skuqet kush sot
më thuaj
sa kushton hileja

Teatër

para teatrit
kompozim ngjyrash
e personazhesh
të dëshpëruar
me egon vulgare
me ambicie mesquine
të mbështjellë tërkuzë

cilën dramë po përgatisin
për publikun shqiptar
në mos prapë
„Godonë“ vallë

Silikoni

bastardët e menduan
t'ia venin silikonin në gji
Kosovës nënë
që të mos i zë mallkimi
i saj në zemërim

haram ju qoftë silikonin
i gjinjve të mi!

bastardët shpëtuan
slikonin zbuluan
në kurriz të atdheut
gërmuan
tani
pa frikë nga mallkimi
i gjinjve shterpë me silikon
të Kosovës nënë

Karriget

si orendi në Parlament
karrige shumëgjyreshe vunë
të zbrazin vrerin kundër njeri-tjetrit
deputetët

në karrige të parin vunë
me legen në duar
për të mbajtur radhën e zbrazjes
respektoni radhën tani
ju vrerëzi
ngacmuesi i vrerit ju fton

Murtaja

për vendin vakant
kambana e përmbysjes së madhe ra
nga shoqëria vakante u dogjëm
tautologji e stërzgjatur
mekje pranverore
minjtë e mbeturinave të qytetit
murtajë po përhapin
kurthi s'po i zë
në kurth
pa (me) dashje
kemi rënë ne

Kosova

po të ishe vetëm imja
do ta mbaja nën xhaketë
mos të kapi alergjia
nga poleni i pavarësisë
të paktën edhe këtë pranverë

gogoli ynë
po frikëson sorrat
në stinët pranverore
me herdhjet e dashit
varur në degën e qershisë
për t'i vënë ato të xhumave
në shenjë flijimi
në themelet e pavarësisë
Kosovë e therorizuar
me fat flijimi

Kodoshët

para brekusheve të kuqe
të një të përdale në kalim
përkulën ata
si para flamurit të lirisë
dhe...
jemi burra
thonë
alibi e burrërisë
prej kohësh katandisë
e në baltë rënë

Kopshtarët e atdheut

kopshte me fjalë ndërtuan
pallate mbi shtatin e atdheut
ulur këmbëkryq mbi postaqinë e iriqit
burrat e politikës
për hir të elektoratit
prapanicën po sakrifikojnë

qëndron e patundur
bythë e larë në gjak
me postaqinë e iriqit
urojmë
elektorati të merr hak

ati ynë pat thënë
të ngrohet hamami me pordhë
o burra
të pastrohemi se u bëmë horr

Koalicioni

që kur bota mban mend
ujku me qengjin
pula me dhelprën
miqësi nuk kanë zënë

atëherë
mbi kë do të bjerë rrufeja
o arkitekt i dredhive të liga
ti nuk je
Pasha Sinan

fantazi perfide e dredharakëve
me foshnjen e pafajshme në gji
mashtuesit
këtë vit
bënë në prapahije kumbaritë
thellë në gjoks fshehur
fshehur pabesitë

Pluralizmi

sistemi shumëpartiak
ta mat e s'ta jap
një bythë karrige

i dëshpëruar ai klithi
lavire politikë

shfryrje e gabuar
folklorizëm prapanik
shfryj po deshe tani
shfryj prapë
lavire politikë
ta mat e s'ta jap

Dëshirë

për të qarë dëshiron
e loti nuk të vjen
dëshiron të qeshësh
e qeshura nuk të zënë
dëshiron të vdesësh
vdekja nuk të merr
kot

jetë hequr padrejtësisht e zvarrë
si hardhuca e përhirtë
mbi bezen e bardhë
synime të porealizuara
jetë dëshirash
kallë

Bijtë e kotësisë

po t'i shikosh
nga pamja e jashtme
të duken
sikur secili me vete bartë
në gji
nga një copë histori

dilemë për pak çaste
vrasje e butë me çaj e duhan
dënim absurd
pajtim me shëmtitë
ata vetëm meditojnë
as gjë nga jeta
nuk kërkojnë

RRUGË E GJATË

Eliminimi

bartur fshehtas
nga sirtarët e diplomacive të mëdha
edhe në krahët e Kosovës
virusi i eliminimit
ra

me shëndet
mbiu edhe në Kosovë
pema e pasigurisë
me frutat që të mbesin në fyt

reliev i thyer i strategjisë gjeopolitike
mes rrugëve dhe njerëzve
virusi i dyshimit
ngrehur si thikë

Unitet

gjyshja ime ndjesë pastë
me dorën e saj të lehtë
nga shtëllunga e leshit
fijet i lidhte në unitet

njerëzit e kohës moderne
si grykësit që zihen për një presh
unitetin e kohës së vonuar
prapë e bënë lesh

leshi e lëmshi u ngatërruan
në fushat e gjera të interesit
o gjyshe ime e ndjerë
u dhje ndër vete
uniteti ynë
prej leshit

Dikur dhe tani

dikur
kur lumin kalonin të ligjtë
dihej
atkinë ta shanin

tani kur lumin kalojnë
atkinë
më nuk ta shalojnë
kohë moderne e avancuar
tani
t'ëmë ta lodrojnë

Premtim

bukën e lyer me premtimin e thatë
po e hanë
tri herë në ditë
burrat dhe gratë
populli im
në pjatën e pistë
na bëftë mirë o miq

imagjinatën e shterpës shpresë
tmerrësisht ftohur e në ethe
shëroje o popull im pjellor
futja një medikament
të skaduar nga pas premtimit
edhe nga një pordhë
ne qofshim me shëndet
kolera i zanoftë
premtuesit e bërë horë

Rrugëtim

gjatë rrugëtimit
diçka u këput në mes
të paralajmëruar për defektin kohor
të shoqërisë kryeneçe
kush parashikoi ngritjen e bajrakut
e nuk parashikoi prishjet
mes bajraktarëve

ai nuk gjeti kompromis me ndreqjet
plagët e hershme nuk u shëruan
fatkeqësitë kujdestare
në pusinë e ligësisë qëndruan

tani
merre e mbaje në gji
rrotën tënde
që ju la në mes të rrugës
të zhgënjyer

kjo nuk ishte karrocë me histori
si ajo e Ismail Qemalit
të merr lumi karrocën edhe ty
mbaje mirë në mend
se historia nuk ta bën brenda saj kot
as edhe një prapanicë vend

Një lum

një lum injorantësh
në rrugën e një të mençuri
në këtë kohë të urtësisë filozofike
presin një fjalë
ka njerëz që s'kanë nevojë të shprehen
sepse kuptohen

një lum të mençurish
në rrugën e një injoranti
në hapat e sajë koha gaboi
ka njerëz që domosdoshmërisht
kanë nevojë të shprehen
sepse nuk kuptohen
ka njerëz që shihen
e nuk kanë nevojë të tregohen
banalitet i imponuar
ka njerëz që duan të tregohen
e nuk shihen
liria e mendimit dhe
mendimi i lirë
dy gjëra konceptualisht
të ndryshme

ka njerëz që nuk kanë nevojë të zhvishen
lakuriqësinë nuk e mbulojnë dot
megjithatë ky gërshetim i së bukurës
mbi këtë skenë të shëmtuar

Mehmet Bislimi

art nuk mund të krijojë
aktorët i mori lumi
pa gjë
pa hiq
krejt lakuriq

Në mes

në mes të strajcës së kurbetçiu
dhe buxhetit të Qeverisë
një vrimë llogari- rrjedhëse
mohuar sakrificë për bukën e djegur
kur nevojën më nuk ta kanë
ta shajnë bukën e djersën tënde
të mohojnë
të bëjnë haram

kurbetçiu me strajcën e shpresave
me krahët e kërrusur
e kokën varë
ikën prapë
pa strajcë erdhi dje
kush një fjalë të mirë s'ia tha
pa strajcë
dyert ishin mbyll
mirëseardhja u dhje

dallimi mes ndërgjegjes dhe strajcës
lumë i madh
ndërgjegje e futur në strajcë
ndërgjegje gërmadhë
në udhëkryqet e kurbetçinjve
zhgënjimi
sa një mal

Autopsi

mes trishtimit dhe shpresës
për ngritje
në shkallët e jetës
në pikën më të lartë
atje
ku fillon rënia

telepati zhgënjyese
mes shpresave
të rrënuara të lakmisë
për të arritur lartësitë
pameritueshëm

gjatë rrugës në marshim
ndeshur me betejat në braktisje
autopsinë shoqërisë duhet bërë
për të zbuluar
sindromën e dyshimit
autopsi shoqërisë
sa më parë
shkakun e vdekjes së bujarisë
për të hetuar
për të parë

Përgjegjësitë

nuk është e lehtë
sot
të ligjtë duan t'u bishtnojnë
përgjegjësive të bëmës së vet

në fakt
ka që hanë bukën e huaj
dhe bartin hallin e vet
më keq për ata
që bukën e vet hanë
e hallin e huaj mbi supe mbajnë
barrë kot
mos u mashtroni o njerëz
para robit e zotit
përgjegjësisë s'i ikim dot
hallit të vet secili
t'i dalë zot

Dorëheqje

fituan a humben ata
me ikjen tënde të detyrueshme
gjuhë e zhurmshme në gojën e heshtur
nuk të dëgjuan perënditë
dorëheqjen ofruan orakujt
sa ditë e mbarë
burrat ikën nga hajnia
hajnat nga burrëria

më thuaj
ranë gjërat në vend të vet
më thuaj
shpëtuam nga ligësitë
më thuaj
nëse zgjedhja u gjet

Ai

nuk e kishte menduar kurrë
se zgjedhjet e çastit dallojnë
aq katërçipërisht
nga ato të perspektivës

në intimitet po ta them
ai bëri koalicionin e zhgënjimit
një fund të tillë s'e kishte menduar
as në moshën e adoleshencës

tani më
në këtë moshë të thyer
lojërat e fëmijërisë i hynë në qejf
si të thuash
iu bënë ves
që nga ati
mos të zbres

Pritje

kjo kohë e lazduar
shumëllojshmërinë e pritjes ta ofron
përtej hijeve te tejdukshmërisë
si të vjen për së mbari
ulur a në këmbë
në luadhe mbi bari
në radhë
në zyrë
në trotuar
pritje shtrirë
i plogësht nën jorgan
pritje fytyrëvrarë
ngazëllyer e hijerëndë
pritje fytyrëshëmtuar e dhëmbërënë
dehur e tymosur me çaj e duhan
pritje

të gjithë ata që presin
janë të vonuar
si të vonuar në jetë
në dyert e mbyllura të botës
trokasim kot
trokasim me vonesë
tash e sa vjet
të vonuarit kush i pret
më thoni
se më luajtën mend e kresë

Nudo

ata ecin të heshtur
tokën shkelin me druajtje
me shikimin e vrarë përdhe
të zhveshur para kësaj bote

sqarohuni
qoftë në mënyrë simbolike
pa zhurmë e bujë
të vërtetën tregoni
nëse
rrobat janë e vetmja
mbuloja juaj

Çelësi

ah sikur ta kisha çelësin e kujtesës
fantazinë do veja në lëvizje
mrekullinë do bëja
që në pikënisjeje

ne edhe kur vuajmë nga harresa
çelësi i memories nuk është në dorën tonë
për ta hapur derën e kujtesës
kujtohemi atëherë
kur bëhet tepër vonë

KURESHTJE E VRARË

Atdhe

atëherë moti
kur ta prenë kërthizën
ta prenë në vend të keq
atë botë ishin të “rinj” ata
sot
sylesh pleq

kush është babai i papërgjegjesisë kombëtare
a mund të zbulohet me anë të ADN-ës
atësi e matrapazllëkut politik
papërgjegjësish
në udhëkryqet e kryeneçësisë
mbetëm të zhuritur keq
pushtuesin kishin përqafuar
syleshët pleq

Kundërshtarë

sa mirë të tillë që jemi
ligj i përsosur i natyrës nuk gaboi
të njëjtë nuk na bëri
mrekullisht
në udhëkryqet e jetës
nuk na ngatërroi

në rrugëtime
në mendime
në veprime
të ndryshëm
ju në rrugën tuaj
ne në rrugën tonë
sa mirë që nuk jemi
të gjithë njësoj

Pleqnarë

moshë
ngatërrim me urtësinë
vërtetë
kot nuk e kanë thënë
ka “pleqnarë” të çoroditur
që gropat bëjnë natën
dhe ndajnë “urtësinë” ditën

Plagë të thella

nga kohët e pa kohë
fatkeqësisht
plagët hapur mbetën
“urtësi” e dhelpërisë së vjetër
ku fshihesh vallë

u mundova të kapja
diçka nga uni yt
edhe nga këndi tredimensional
kot
në sfondin e artit pamor
identitetin tënd
kund s’e gjeta
vlerësim i gabuar imi
mbase
identitet i rremë
me dashje mos të bëhemi
ngacmues të plagëve të shpirtit
si krimbi në rrem

Në rrugë

shumë kohë më parë
akorduar
nga gjithë ato rrymime
gërvishtje e murtajës së vvarë
në kasabatë e lashtësisë
në ri- përpëlitje
nuk kthehet më kohë
e “namit të lisë”

peripeci tundimi e dileme
melodia e sonatave të vona
në ekzekutim
tmerrësisht të papërgatitur na zuri
peshë e pafajësisë
më e rëndë se guri
aq papërfillshëm në rrugët e humbjes
gurët na i vunë
përfundimisht na iku gjumi
dhe prapë të tjerët tinëzisht
në gjumë na vunë

Kureshtarë

jam shumë kureshtar
për të kuptuar diçka më shumë
se nga hera tjera
nëse e kalove suksesshëm
pragun e adoleshencës
kësaj radhe

kryeneçësi që kushtoi
futur në vallen e dështimeve
për hir të vërtetës
fatkeqësisht
nuk mësove as gjë
nga sprovat e jetës

Tentim

ehu
gati u tmerrova
pamje e ritransmetuar përçudnisht
nga pamundësia e përballimit
një qerre akuzash
kohë e mohuar në heshtje
as një protestë
as një lëvizje
as një fjalë

tek sheshi ishte grumbulluar kureshtja
një statujë bëri tentim vetëvrasjeje
si trumcaku i Migjenit dikur
gënjeshtra të largëta zbuluar nga heshtja
tenton të vetëvritet
një statujë
në mesin e sojit të vet
për ironi
kishte mbetur e vetme
kishte mbetur e huaj

Ngatërresë

në sprovë
nga dërrasë e parmakut
rrugë burrërie ngatërruar
deri tek balli i oxhakut
e hëngri peshë e urtisë
pavetëdijshëm futur në lojë

më thua
ku është mesi i papërgjegjësisë
e pashpjegueshme
ligji i pashkruar i kullës prej guri
ku peshohet morali në kandar
i kërkon vet vendi
burrat
i kërkon oxhaku
në ballë

Ai vdiq

vdekja ka mandatin e vet
në përjetësi kush do futet
formulën e përjetësisë
kush na e gjënë

mënyra e të perceptuarit
për mes veprës së njeriut
që rrugë ndërtoi
ne
si kalimtarë
thjesht numra njerëzish
që rrugëtojmë
nga dera e botës së madhe
pa dyshim
hynë e dalin emra që gjurmë lënë
por edhe anonim

Si gjithmonë

dirigjent
orkestër që dështoi para akordimit
tingujt e çakorduar
fatkeqësisht
nuk nxorën melodinë e shumë pritur
çfarë peripecish kakofonie
mes tingujsh ulëritës
këtë konfliktualitet notash
kush e dirigjon

të dirigjosh një orkestër
do duhej të ishe
të paktën Maestro
e klasën e parë të notave
nuk e kalove dot
maestro i melodisë
pa nota
maestro kot

Loja me zjarr

kur loznim me zjarr dikur
të vjetrit na thoshin me qortim
mos luani me zjarr
luani me gurë
se do lageni natën nder vete
deri në ushkur

të lagur po gdhihemi për ditë
se zjarrin kishin shuar “miqtë”
kjo besëtytni e vjetër të mbytë
si fëmijë zgjoheshim të lagur
të lagur deri në fyt

vërtetë
ne lageshim në shtrat
se ishim fëmijë
por se lagen tani
nga frika e zjarrit të lirisë
burrat e zi

Larje duarsh

Ilogarit shpenzimet miku im
brije një sapun në të mjafton
unë do kujdesem për larjen tënde
sot do ta nënshkruajmë moratoriumin
mbi orën e vdekjes
se i erdhi fundi lojës disfatiste
me ujin e ftoftë të burimit
larje duarsh nga qëllimi final
rrëshqitje në kohë
me duar të palara
sa afër burimit
sa larg pastërtisë

E tha

ndershmërisht e tha
m'i gjeni njerëzit e sinqertë
dua t'i takoj diku
të shpëtoj prej kësaj brenge
që më hëngri

e tha
m'i gjeni ata

kokën time lë peng
e tha
me gjithë mend
plotësisht e besoj
ani pse kjo datën kallë
ku t'i gjejmë
ata sot
janë shumë të rrallë

JETË HALLEMADHE

Ngatërrim

mbase
me dashje ngatërruan rolet
erdhën rishtarët diletantë
komeditë i bënë paçavure
rolet ndërruan prijatarët
për ta lozur rolin e të dështuarit
në kuvendin e urtësisë
nuk u desh aq mund

mundin shpagoi spektatori
mbase me (pa) dashje
ngatërroi urtarin me horrin
dhe rrugën me oborrin
ngatërrim

Të dehur

“heronjtë” e ditëve tona
esëll nuk i takuam dot
nga tavernë e kafenesë së qytetit
hurbin e kafesë shijojnë
raki e mish të skuqur
lamë e shtruar
koqen e qejfit po bëjnë
namin e zi po lënë

të dehurit e ditëve tona
“për atdhe”
nga mallëngjimi
dehur e përmallë
në tryezën e pistë shtruar
të paskrupullt
faqezi e hileqarë
dehur e bërë përrallë
“për atdhe”
namin e zi po lënë

Halli

të çon në derë të madhe
jeta është me halle
kush më të rënda
hallet
kush me të lehta
askush hallin nuk ta qan
kështu e paska jeta
halli- hallit nuk i ngjan...

Kosovë me barrët e lindjes në shtat
ke vuajtur kaq shumë
ke vuajtur kaq gjatë
me halle Kosovë
me halle Shqipëri
pa hak se ç'po i mbani
bajraktarët mbi kry'

Simbolikë

simbolikë e përfolur
viktimën e radhës ke fiksuar
një përplasje estetike e mendimit
bora që nuk po bie në kohën e vet
fytyrën nuk na e zbardhi këtë stinë
as në mënyrë simbolike
për pasojë
plehrat mbetën të zbuluara
për rreth
e në Prishtinë

kasneci gjel
mbi grumbujt e plehrave të kryeqendrës
me sheshin me rreze radioaktive
kushtrimin lëshon
në mënyrë krejt simbolike
shpresat e humbura rikthen
në kornizat e një ekspozite pamore
arenë përleshjesh
mes qensh bredhacakë
mbi pendlat e një korbi
me rreze uraniumi
aksidentalisht vrarë

vrasësit nuk dihen
as koha e krimit
në vendin e ngjarjes policia

hetimet vazhdojnë
mbi fuqinë e rrezatimit vrasës
simbolikisht e me hopa
vitet nën regjimin e hetimeve
ikin e shkojnë
hetimet
vazhdojnë

sheshi radioaktiv i kryeqendrës
CVI-në radiografike pushtetarëve
për ditë ua bënë
dikush i korruptuar më lehtë
dikë më shumë e rëndojnë
hetimet
vazhdojnë

Mollë e ndaluar

shoqëruesit tuaj besnik
jetë virtuale bënë
pa fjalëkalime e kode
rrugëve të mundimshme
përtej së mundshmes
besnikërisht ju ndoqën
dje

ty mollë e ndaluar
tinëzisht
të kafshuan sot
e në fyt s'i mbeti kujt kafshatë e ndaluar
mes ogurit të lashtësisë
dhe
makutërisë së kohërave të sotme
të gjithë për dike
po paguajmë kusuret e anemisë
ogurin e zi për mollën e ndaluar

atdhe pas shpine tinëzisht
të kafshuan edhe ty
ditëve të festave
ditëve të zisë
të kafshuan bijtë e babëzisë

Do ta pagëzojmë

kush qëndroi në këmbë
pa i ndyrë të brendshmet
gjatë gjithë atyre rrugëtimeve
tej e përtej fushave me gropa
do ta pagëzojmë
sigurisht

diçka e pangjyrë
me erë e pashije
e papërshtatshme
si rënia e borës pa kohë
kur vret lulet e sapoçelura
në zanafillën e vet
as dimër as verë
lojën e hedhur nga të tjerët
si ta pagëzojmë
më thoni njëherë

Me presh

nuk është për t'u habitur
janë bërë tani shumë sylesh
duan të zhvatin me çdo kusht
nga kopshti i interesave
të paktën nga një presh

ata e morën me pahir
preshin e gjatë me mustaqe
as u skuqen as u nxinë
nga turpi në faqe

me gjasë që moti fjalës
kot i paskan thënë
me presh në dorë
keq e paskan zënë
në mos
u vu në lojë urtia popullore
këta nuk e heqin
kurrë preshin prej dore

Nuk përputhen

premtimit të zënë ndër leqe
për fjalën e dhënë të burrit dje
dhe mosmbajtjen e saj sot
bishtin ia zura me çark
e shava burracakun keq
së më gërryente diçka në bark

e shava kot
fjalët e veta i hëngër dje
pa çka
po i hanë edhe sot
si duket skuqja
u dogj kot

Fshehur

të dërmuar nga kthetrat e jetës
orë e vdekjes ia bëhu
zënë ngushtë e pulitur
si kërmilli në gëzhojë
strukur në një qoshe
mbetur pa fjalë
pa gojë

i dobëti njëri
para orës së vdekjes
fshehur e strukur
si kërmill

Miu

të marrtë djalli të marrtë
nën dhëmbë po mallkonte nikoqirja
për bishti miun kishte zënë
miun në kurthe rënë

kurthe - ngrehësi
kishte bërë mirë llogarinë
karremi joshës nuk i shkoi kot
mjeshtri e kurtheve s'është art
por është vet hileja e shtatë
që kap të ligjtë në befasi
të ligjtë hajdutë
me keq
së një mi

Gropat

e luta fyellin
të vërtetën për ta thënë
për gropat në zemër të Kosovës
ai zë nuk nxori
melodi e tij heshtte
gropa pa skelete
Kosovë
histori me gropa
eshtrat t'i grabitën

Avniu

në sallën e gjyqit Avniu
hijerëndë po dëgjon
se si dëshmitarët e rremë shqiptarë
sot
para gjyqit të UNMIK-ut
për dallim nga gjyqi i Parisit dikur
ata sot
Avniun
po e gjuajnë me gurë

Miku

bëni mirë llogarinë
një thes kripë me mikun

mos luani me miqësinë
mikun e vjetër
mos e digjni kot
kot si një letër

Shekujt

mbuluar me petkun e robërisë
shekuj të tërë hijerëndë
që tokat na i gëlltiten
si brejtësit me dhëmbë
tokat pa t'zot
e sot

Lakimi

në rrugët e jetës
do të sprovohemi
para të tjerëve
para vetes

nëpër veta
do të na lakojnë të tjerët
veproni sinqerisht
lakimit mos ju frikësoni
veproni drejt
mos ndaloni

SHEKUJT E PËRGJAKUR

Respekti

në shoqërinë ku respekt i bëhet tjetrit
në shoqërinë ku tjetri respektohet
modestinë dallojmë

asgjë më tepër se
mbi baza të respektit të ndërsjellë
të urtin njeri
admirojmë

Shpirti

gjeneratë e shpirtmëdhenjve
që nuk hapin plagë
kanë vuajtur aq shumë
kenë heshtur aq gjatë

pa dyshim
modestia na kushtoi
në vend të shpagimit moral
si për inat
çmendurisht na u hakmor modestia
dje edhe sot

Shekulli i ri

shekulli i ri
shekulli i ri
skuqur me gjak deri në mjekër
nga barrët e liga
të shekullit të vjetër

flamuj të gjakosur të shekullit të ri
me dashje a pahir
përgjakur
përsëri

Gënjeshtar

prapë
gënjeve shokët e idealit
në rrugët e rrëpira të faqes së malit
faqe nxirë
fjalë ngrënës e i paburrë
i vetëm po
më shokë
jo
më kurrë

Pa autor

shumë u punua për diçka
që në përpjekje të shpaguhet
fuqia e një teledrame
larg ekranit

kush kumtoi kumtin e dështimit
nga syri i dritares me xhama të thyer
nga goja e derës së hekurt
shpërthyen dështimet e shfrenuara
çfarë arrogance e këtyre dishepujve
të kësaj teledrame
pa autor
pa spektatorë
pa aktorë
larg e më larg të gjithë ju
o të ligj
o puthadorë

Dyfytyrësi

në gjithë këtë pështjellim
ti
u shtire me dashje
në rolin e naivit
realizuar përsosmërisht
si aktor

në kohën e papërgjegjësive të mëdha
ti
as aktor
as personazh
as spektatorë
as dëshmitar
s'u bëre i gjallë

Portret

ushqehem me ndjenjën për ty
nga tregimet e të tjerëve
diçka edhe marr
së menduari djersitem
portretin tënd për ta ndërtuar
kur ata të lavdëruan
edhe kur të shanë
e çka s'të thanë

mbi thash e thëna s'ndërtohet portreti
unë piktori që linjat nuk i kap dot
kush do të besonte se
rrëfimi i të tjerëve për ty
do të më dilte kaq i saktë
nga gjithë ajo distancë kohore
edhe sot
portret pa linja
që asgjë nuk thotë

Kufiri

ma gjeni kufirin
mes
dashurisë dhe urrejtjes
gënjeshtërs dhe të vërtetës
moralit dhe imoralitetit
mjerisht sot aktual

më duhet patjetër
dikujt
kufirin t'ia tregoj
seriozisht t'i them
ndal

Daullja

mbi kë do të bjerë rrufeja
nga jonet në fërkim
bërrylagjinj provincialë
bubullimë e pranverës së ftohtë
anatemuesin more
psikologji e argalisur
dehur nga daullja e vjetër
mbi plancin përplasur

dy lekë
darka e lavdërimit
katër lekë
procesi fiziologjik i lirimit

ekonomi deficitare
ta mbash a ta hash
kjo është çështja
do thoshte Shekspiri

Heshtje

o heshtje në fund të fillimit
eufori e krimit
mbi varre zbrazur
rrëqethur e vrarë pikëllimit

skelete të një kombi të pidentitet
shëtisin lakuriq
me pasaporta diplomatike
edhe sa mandate
në Bruksel
Kosovën do të përfaqësoni
skelete të rebeluar
heshtje
ç' trishtim

Pa dashje

ia këputa telin çiftelisë
pa dashje
nuk ia mësova notat melodisë
kurrë
e melodinë e desha aq shumë
djalli ta marrë

për ty më kënga
nuk do këndohet
as vaj s'do bëj kush
vrave këngën me dorën tënde
në rrugët e harrimit
makthi që po rritet
miqtë të thanë
kujdes këngën se vritet

Parandjenjë

armiqtë nuk po na shajnë sa duhet
miqtë po na lavdërojnë
më shumë se ç'duhet

si me të pabesë
se ç'po më gërryen një ndjenjë
një ndjenjë ogurzezë

NDËRGJEGJE NË PESHJË

Ironi e verdhë

vargu im
eja të ikim larg

zilia mes vargjeve
ka rënë
vargjet mes vete pezëm kanë zënë
smirëzia në garë
ikim
se u bëmë përrallë

mes njerëzve urrejtja
fatur kaq thellë
enigmë e pashpjegueshme
ironi e verdhë
ikim

Gjithmonë

mes fjalës e keqkuptimit
një ngushëllim i vogël
gjithmonë

mes shtirjes e virtytit
shqetësimi si fryt
gjithmonë

kungulli mbi ujë përherë nuk shkon
kanë thënë
i ndershmi të nderon
gjithmonë

Ndaras

ka kohë e vite
qe shpirti ndarë
nga trupi im
jeton

me shpirt në Kosovë
me trup larg saj

në buzëgrykën e një pusi
të pafund e në vaje
ngulur trupi im
si idhujt pa koka
na hëngri
toka
e huaj

Shqip

po ju paralajmëroj për të satën herë
luteni
mbani qetësi
kjo inteligjenci e privuar nga fjala
tani flet të vërtetën
pas derës së rëndë të hekurt
në atë gropë
flitet shqip

në fantazinë e tyre
ka diçka madhështore
e rëndë pa dyshim
edhe një herë
paralajmëro inteligjencinë
flisni
shkurt dhe shqip
mbroni të vërtetën

Varje

nga fijet e mjekrës sate Pasha
po zë fill një tërkuzë
mbi sfondin jeshilë
në vertikalen e paskajoreve
heshtat helmuese u përthyen

pabesi kujt i ke ngreh
pasha i verdhë
pabesi
rrënjët ku i ke
makthi në gjumë të vraftë
pasha arkaik
i ditëve tona
rrënja t'u thaftë

Medaljoni i ndryshkur

prej kohësh mungojnë
sfiduesit e tij
në qafë të kujt do ta varim
atë teneqe me tojën e leshit
ngjyrë portokalli

në qafë të paçin Kosovë
qafë-tojë-leshtit
portokall-ngrënësit
e teneqe-medaljon-punuesit

Mashtruesi

të jetë ai vërtetë
ndërtuesi i kështjellës

unë
nuk e besoj
shtiret ai
nuk e beson as vetë
na hëngrën pritjet e gjata
na hëngrën me të pabesë
kështjellë
o mbetsh shkret

Gjysmë

në atë gjysmë terr të asaj nate
atje përtej ku po gdhinte
sytë e saj gjysmë të mbyllur
në gjysmë buzëqeshjeje
heshtje gjysmë e pabesë

një jetë diellin kërkuam
trullosje e pashpresë
gjysmë lagur me vesë
gjysmë ëndërr
gjysmë zgjuar
gjysmë robëruar
gjysmë çliruar
gjysmë
pjesë e tërësisë
së pa bashkuar

Pikëllim

e bardha që vret
gjenezën e ka të lashtë
lashtësi e përtejme
bari mendueshëm ngrihet në pranverë
si i sëmuri nga lëngimi në shtrat
me shtatin dhe gishtërinjtë e verdhë
se dimri ishte i gjatë

Fjalë dhe gurë

fjala s'e lëvizi gurin dot
as guri fjalën e thatë
e goditën dhe fshehën dorën
të urtin njeri në shtat

ata hodhën gurë e fjalë
dhe dorën prapë fshehën
goditën të sotmen
më keq
të nesërmen

Urtari

në përleshje me ashpërsitë e jetës
nuk luhatet
gjërat nuk i lë zap
në duar të fatit
një jetë ka ecur vertikalisht
nuk i frikësohet hapit
s'kanë ç'i bëjnë të ligjtë

Kujtim

kujtime të përjetshme
ato
të rënieve heroike

kujtime të hidhura
ato
të dredhive mistike
botë e ligë
kujtime vragëlënëse

Valët

valët e jetës dhe valët e detit
të përbashkët
kripën kanë

rrahur nga hallet
pamëshirshëm
rrahur nga dallgët
furishëm

mbi gjoksin e shkëmbit
mbi gjoksin tonë
zbrazën mllefin paudhësitë
të përkushtuarit nuk u dhanë
vetëm ata qëndruan
në këmbë

Rrënojat

pengesë
në rrugët e ardhmërisë
rrënojat e kalasë që diktojnë
të lëna anash prej historisë
rrënojat kush uzurpoi
uzurpuesit e rrënojave morale
moralisht të rrënuar
lisa të vrarë ndër male
gjethet pikojnë gjak
të rrethuar me rrënoja
prapë

Aradhja

u rritë aradhja
nga
më të mirët
munguan nga aradhja
prapë
më të mirët

mbetën jashtë aradhes
përjetë
të medyshurit

PORTRET NË PASQYRË

Cezari

zaret u hodhën
pati thënë Cezari
kur kaloj lumin Rubikon

zaret u hodhën
ju
mos prisni t'i hedhin të tjerët
merrni vendime
e mos ngurroni
për fatin e atdheut

Zhgënjim

zhgënjehemi kur
miqtë në baltë na lënë
pa pandehur
dilemat paraqiten
cilët janë miqtë e vërtetë
e cilët
miq na hiqen

I sinqertë

i sinqertë
keqkuptim

në botën tonë të zvogëluar
kohë e të pasinqertëve
në skenë
në mos
bota e tillë paska qenë
e ne s'e kemi vënë re
të pasinqertë e zagarë
ndihemi të zhgënjyer
fatkeqësisht me kohë
s'i kemi parë

Me keqardhje

dikur
mendimet i kishim të njëjta
për njeri tjetrin
kishim nevojë

përditë po largohesh
vërtetë më vjen keq
jo edhe aq për ty
sa
për mangësinë që s'e heq

Dimri

borë e bardhë si petkat e lara
varur mbi degët e pemës
bardhësi që gënjen
ndjenjat e marra
të bulimit në gem'

në kohën e pa kohë
të varfërit në shtrëngim
kasolle e mjerë
s'nxjerr flakë as tym
nga oxhaku i trishtimit
larg lindjes së diellit
veç trishtim

Evropa

në pasqyrën e tyre
portretin tonë shtrembër prezantuan
galeritë e shurdhëta ndër shekuj
pulitur

ngjyrë e ujë
brushë e huaj
piktor memec
në pasqyrën e vjetër
gjeni të vërtetën
për ne
pa dyshim
edhe për veten

ndër shekuj gënjyer
me pahir
nga memecët e kohërave
të shurdhëta
të verbëta
Evropë e pikturuar me gjak
po ne
kujt i patëm hak
dinakëri e vjetër e politikës
heu lia t'raftë

Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare

prapë dikush do të vritet
do të përgjaket dikush
prapë dikush do të zgërdhiet
do të përjargët dikush

kambanat për mortin
nuk do të pushojnë
dikë do ta shajmë me breshëri
me breshëri
dikë do ta nderojmë

rrugë të gjata janë këto
kanë nisur e nuk sosen
bashkimin e atdheut
kërkojnë

Mërgimi

nga qengj i butë
të del ujk me dhëmbë
të tretë
të dërmon
buzëqeshjen ta ndrydh malli
tkurresh e nuk mbetesh
sa një kokërr limoni

Shqiponjës

(*varg i huazuar*)

dua ta huazoj një varg
për ty
për të bukurin flamur
në gjunjë para teje
burrat janë përkulë

... “Sot shumë korba thonë jemi shqipe / si i duron
e kryet s’ua shtype!”

Ma jepni shkopin

më duhet të mbështetem diku
pranë lartësive të bardha
si zogju që fluturon mbi re
larg e më larg nga përbaltja

jam i vetëm tani
i vetëm fillikat
natën duke e çarë
me shkopin e gjatë
mos më ankoni tani
se nuk ua fal dot

Kam nevojë

për ty kam nevojë
toka më rëndon
Sizifi do të m'i verbojë sytë
që plotë dritë i kam

ti
popullin zhveshe
nga ndjenjat e robërisë
pinguinët po të shajnë
larg
mbi akullin e ngrirë
për ta thënë të vërtetën
kam nevojë
pinguinëve le t'u mbetet
e shara në gojë

Zvicër, 2012

Shënime për autorin

Mehmet Bislimi lindi më 24 mars 1958 në fshatin Prekaz të Epërm të Skenderajt. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, kurse gjimnazin në Skenderaj. Në Universitetin e Prishtinës studioi shkencat natyrore. Në vitin 1981, për shkak të veprimtarisë atdhetare, arrestohet dhe dënohet me burg. Pas daljes nga burgu, më 1986, veprimtarinë kombëtare e vazhdoi në gjirin e LPK-së, ku pati detyra me përgjegjësi. Në vitin 1994, i përndjekur nga regjimi serb u strehua në Zvicër.

- Gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka bartur detyra me përgjegjësi.

Me krijimtari letrare ka filluar të merret që herët. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën "Bota e re", Prishtinë, 1986. Më vonë në revistën "Alternativa", në Lubjanë, si dhe në disa numra të gazetës "Rilindja", që botohej atë kohë në Zvicër.

Disa vjet ka shkruar për organin e LPK-së "Zëri i Kosovës" që botohej në Zvicër dhe për të përkohshmen "Ruga jonë"- që dilte në Francë. Në të dy gazetat, për një kohë të gjatë, është paraqitur edhe me këndin e humorit me nofkat "Ngucakeqi" dhe "Gjemb". Kohë pas kohe shkrimet e tij kanë gjetur vend edhe në gazetën

“Epoka e re”, “Lajm”, “Kosova sot”, “Shekulli” etj., si dhe shkrime të shumta në dhjetëra faqe elektronike. Veprimtaria e tij letrare përfshin shkrime publicistike, anekdota, humor, poezi, prozë, si dhe mendime të urta popullore etj.

Deri më tani ka botuar këto libra:

- 1. "Anekdota popullore dhe satira autoriale I", Prishtinë 2002**
- 2. "Trëndafila maji" – poezi, Prishtinë 2002**
- 3. "Fjalë dhe gurë" – poezi, Prishtinë 2003**
- 4. "Këtu i thonë Drenicë - Tahir Meha – monografi“, Prishtinë 2004**
- 5. "Ironi e verdhë" - poezi, Prishtinë 2005**
- 6. "Stinë e vonuar" - poezi, Prishtinë 2008**
- 7. "Shkrime publicistike", Prishtinë 2009**
- 8. "Anekdota popullore dhe satira autoriale II" - Prishtinë 2010**
- 9. “Mehmet Delia - alias Mehmeti i Vogël”- monografi, Prishtinë 2011**
- 10. “Shpirtndrituri”- poezi, Prishtinë 2012**
- 11. “Burrëri e lagur”- poezi satirike, Prishtinë 2012, është libri i tij i radhës.**

Përmbajtja

HYRJE	5
FJALA E REDAKTORIT	7
LISI I MPLAKUR.....	9
DIKUR	10
DËSHMITARË.....	11
DY TË MARRË.....	12
BYTHË E KUSISË	13
TELEFONI.....	14
LAJM I VONUAR.....	15
RËNIE	16
TË GJITHË	17
BOJËN KURSEJMË	19
KLASË E DËSHTUAR	20
SHPREHI.....	21
DJALLËZI E MBARË	22
DRAMË	23
DEHJE.....	24
LUMI QË S’NA LANË	25
ROBËRIT	26
SINTEZË FATALE.....	27
GOMARI.....	28
HOROSKOPI.....	29
MITROVICË	30
EDIPI	31
PËRRALLË.....	32
DORDOLECI.....	33
PADREJTËSISHT	34
KUSHTRIMI	35
STATUJË	36

KA BURRA.....	37
VRET FJALA	38
PUNËTORI	39
BURRËRI E LAGUR.....	41
DALLIMI	42
ISHULL.....	43
DILEMË.....	44
PIKËPYETJE.....	45
SHKËLQIMI QË VRET	46
MURALET	47
A DO KARROCË ZOTËRI	48
KATARSIS	49
DIVORCIMI.....	50
BURRËRI	51
ANONIM.....	52
BARRËSE	53
SERVILIZËM	54
TË MARRËT	55
SHPËTIM NGA MALLKIMI.....	57
PARTITË.....	58
STANDARDET	59
LIGJI	60
TEATËR.....	61
SILIKONI	62
KARRIGET	63
MURTAJA.....	64
KOSOVA	65
KODOSHËT.....	66
KOPSHTARËT E ATDHEUT	67
KOALICIONI	68
PLURALIZMI	69
DËSHIRË	70
BIJTË E KOTËSISË.....	71
RRUGË E GJATË	73

Burrëri e lagur

ELIMINIMI	74
UNITET	75
DIKUR DHE TANI.....	76
PREMTIM	77
RRUGËTIM	78
NJË LUM	79
NË MES	81
AUTOPSI	82
PËRGJEGJËSITË	83
DORËHEQJE.....	84
AI.....	85
PRITJE.....	86
NUDO	87
ÇELËSI.....	88
KURESHTJE E VRARË	89
ATDHE.....	90
KUNDËRSHTARË.....	91
PLEQNARË	92
PLAGË TË THELLA	93
NË RRUGË	94
KURESHTARË	95
TENTIM.....	96
NGATËRRESË	97
AI VDIQ.....	98
SI GJITHMONË	99
LOJA ME ZJARR	100
LARJE DUARSH	101
E THA	102
JETË HALLEMADHE	103
NGATËRRIM	104
TË DEHUR	105
HALLI	106
SIMBOLIKË.....	107
MOLLË E NDALUAR	109

Mehmet Bislimi

DO TA PAGËZOJMË	110
ME PRESH	111
NUK PËRPUTHEN	112
FSHEHUR	113
MIU	114
GROPAT	115
AVNIU	116
MIKU	117
SHEKUJT	118
LAKIMI	119
SHEKUJT E PËRGJAKUR.....	121
RESPEKTI	122
SHPIRTI	123
SHEKULLI I RI	124
GËNJESHTAR	125
PA AUTOR	126
DYFYTYRËSI	127
PORTRET	128
KUFIRI	129
DAULLJA	130
HESHTJE	131
PA DASHJE	132
PARANDJENJË.....	133
NDËRGJEGJE NË PESHOJË	135
IRONI E VERDHË	136
GJITHMONË.....	137
NDARAS.....	138
SHQIP	139
VARJE.....	140
MEDALJONI I NDRYSHKUR	141
MASHTRUESI.....	142
GJYSMË	143
PIKËLLIM	144
FJALË DHE GURË	145

Burrëri e lagur

URTARI.....	146
KUJTIM.....	147
VALËT.....	148
RRËNOJAT.....	149
ARADHJA.....	150
PORTRET NË PASQYRË.....	151
CEZARI.....	152
ZHGËNJIM.....	153
I SINQERTË.....	154
ME KEQARDHJE.....	155
DIMRI.....	156
EVROPA.....	157
USHTRISË ÇLIRIMTARE KOMBËTARE.....	158
MËRGIMI.....	159
SHQIPONJËS.....	160
MA JEPNI SHKOPIN.....	161
KAM NEVOJË.....	162
SHËNIME PËR AUTORIN.....	163
PËRMBAJTJA.....	165

ISBN

**Tirazhi
200 copë**

**Formati
120 X 190**

**Shtypur në shtypshkronjën
Shkrola Print
Prishtinë
2012**